



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 115/2013

Prishtinë, më 24.07. 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S–II

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha–Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Ethem Arifi.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi - ZPRK; Burim Ejupi, Dita Dobranja dhe Dardan Abazi – INDEP; Donjetë Hoxha - BIRN – gazetarë; Fehmi Preva – Kuvendi i Kosovës; Qëndresa Mrasori – praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16.07.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit –AKP, për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i Rekomandimeve në lidhje me funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës - AKK;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – I informoi anëtarët e Komisionit se për pikën e tretë- Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit-AKP për vitin 2012, nuk mund ta shqyrtojnë, pasi që është njoftuar nga përfaqësuesit e AKP-së se nuk mund të jenë të pranishëm sot në mbledhje dhe propozoi që kjo pikë e rendit të ditës, të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Deputetët u pajtuan me propozimin e kryetarit.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, duke hequr pikën e tretë.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16.07.2013

Procesverbali i mbledhjes së datës 16.07.2013 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Rekomandimeve në lidhje me funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës - AKK

Kryetari – Tha se në mbledhjen e kaluar diskutuam për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, ku ishin të ftuar tre anëtarët e Bordit të AKK-së, me të cilët u patëm pajtuar që stafi mbështetës i Komisionit, në bazë të diskutimeve, të përgatisë një draft me propozim- rekomandime, këtë draft e ka hartuar Stafi i Komisionit, andaj për ndonjë ndryshim të mundshëm, mund të diskutojmë. Më pastaj, e hapi debatin.

Lutfi Zharku – Tha se pajtohet në parim me dokumentet e hartuara, por tek “Kërkesa” për Kryesinë e Kuvendit, duhet të thuhet: “Të kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që me urgjencë të procedojë propozimet...” e jo siç është tani. Po ashtu, tek “Rekomandimet”, te pika 2, afati prej 15 ditësh të ndryshohet në 30 ditë dhe te pika 3, të shtohet teksti “me përjashtim të menaxhimit të administratës, të cilin e ushtron UD i kryetarit, përmes sekretarit të AKK-së”.

Deputetët u pajtuan me propozimet e z.Zharku.

Myzejene Selmani – Tha se pajtohet me këto ndryshime, të propozuara nga z.Zharku dhe Qeveria duhet sa më shpejt t’i sjellë propozimet për anëtarë të rinj të Bordit, sepse ne po marrim vërejtje nga Brukseli, për shkak të mosfunksionimit të AKK-së.

Shaip Muja – Tha se do të duhej të sqarohej më tej pika e 5-të, te “Rekomandimet” se kush duhet të bëjë ndryshimin e lokacionit, sekretari i Kuvendit apo vetë AKK-ja. Po ashtu, potencoi konfliktin e interesit për dy anëtarët që janë në marrëdhënie pune në universitete private dhe kjo bie ndesh me ligjin.

Hashim Deshishku – Tha se Qeveria duhet t’i propozojë jo vetëm dy anëtarë, por katër anëtarë, sepse edhe dy të tjerë iu skadon mandati në nëntor.

Sala Berisha – Shala – Tha se tek pika 4, tek “Rekomandimet”, ku thuhet të ndryshohet Statuti, ajo propozoi që së pari duhet të ndryshohet ligji dhe mandej Statuti, sepse Statuti duhet të jetë në frymën e Ligjit.

Lutfi Zharku – Sa i përket ndryshimit të Statutit, mund të ndryshohet, sepse neni 30 i Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës thotë se çështjet e brendshme rregullohen me Statut dhe ne kemi propozuar që vetëm te pika 4, të definohen kompetencat e menaxhimit të brendshëm.

Kryetari – Tha se sa i përket çështjes së konfliktit të interesit, zgjidhja më e mirë do të ishte që t’i dërgojë një shkresë Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ata të japin një opinion ligjor apo interpretim të dispozitave të caktuara, sepse ka paqartësi në ato dispozita, siç është neni 26 paragrafi 3.1 dhe neni 31, paragrafi 2 i ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Deputetët u pajtuan me propozimin e kryetarit.

Pas debatit, Komisioni vendosi që Kryesisë së Kuvendit t’ia parashtrojë këtë

Kërkesë

Të kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që me urgjencë të procedojë propozimet për dy vendet vakante, që nga nëntori i vitit 2011 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës, ku njëri prej tyre të nominohet për kryetar të këtij Komisioni, si dhe të vazhdohet me përgatitje për propozimin e dy anëtarëve tjerë, të cilëve iu përfundon mandati më 24.11.2013, në përputhje me nenin 25, paragrafi 4 i Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës.

Dhe, Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës ia paraqet këto

Rekomandime

- 1. Konfirmohet si ushtrues detyre i kryetarit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, z.Ahmet Krasniqi, detyrë të cilën do ta ushtrojë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Komisionit;*
- 2. Deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, ushtruesi i detyrës së kryetarit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, duhet të njoftojë Komisionin parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me një raport të detajuar, çdo tridhjetë (30) ditë kalendarike lidhur me punën e Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës. Raporti duhet të jetë i nënshkruar nga tre komisionarët;*
- 3. Të gjitha vendimet në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës, duhet të merren me unanimitet të plotë të të gjithë komisionarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në pajtim me nenin 29, paragrafi 2 dhe nenin 25 të Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës, me përjashtim të menaxhimit të administratës, të cilin e ushtron UD i kryetarit, përmes sekretarit të AKK-së;*
- 4. Të hartohet plotësim- ndryshimi i Statutit të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës nga komisionarët e Komisionet për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe t’i dorëzohen Komisionit parlamentar në afat prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike, nga pranimi i këtyre Rekomandimeve. Plotësimi dhe ndryshimi i Statutit, të fokusohet në veçanti në rregullat e funksionimit të brendshëm dhe kompetencat e kryetarit të Komisionit, anëtarëve të Komisionit dhe stafit civil të AKK-së, si dhe në bazë të propozimeve tjera shitesë që ka*

AKK, në lidhje me moszbatimin e dispozitave përkatëse të Statutit, në pajtim me nenin 19 të Statutit;

- 5. Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në pajtim me buxhetin e ndarë nga Kuvendi, detyrohet që urgjentisht të gjejë lokacion adekuat, që të krijohet hapësirë e nevojshme për vendosjen e stafit të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, në mënyrë që të krijohen kushte reale për punë në ushtrimin e përgjegjësisë që dalin nga ligji.*

4. Të ndryshme **Çështjet vijuese**

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

**Kryetar i Komisionit,
Zenun Pajaziti**